



BULETINI MUJOR

Janar – Qershor
2025



Si çdo fillim viti u mbajt për vitin 2025 aktiviteti mbi Fondin Social, në të cilin u nënshkruan Marrëveshjet e Bashkëpunimit mes Shëbimit Social Shtetëror dhe pushtetit vendor për financimin e shërbimeve të reja sociale në territor. Fondi Social ka kontribuar në ofrimin e 84 shërbimeve komunitare në 59 bashki dhe 8 qarqe, duke përmirësuar jetën e mbi 44 mijë qytetarëve në nevojë.

Me angazhimin e 681 profesionistëve dhe një buxhet prej 1.5 miliardë lekësh, ky fond po siguron shërbime të qëndrueshme dhe të aksesueshme për ata që kanë më shumë nevojë.

Në kuadër të projektit "eldEarly – përmirësimi i sistemit të përkujdesit për të moshuarit" SHSSH në bashkëpunim me ASET ka publikuar Hartën Elektronike të Shërbimeve për të Moshuarit në Shqipëri, mbështetur nga IADSA II.

Harta paraqet informacion të detajuar dhe të përditësuar mbi shërbimet e disponueshme në vend. Ajo përmban të dhëna për numrin e shërbimeve, mbulimin gjeografik, tipologjinë dhe kapacitetet e tyre. Aksesoni hartën në link-un:



<https://asetcenter.al/harta/>



8 Marsi i grave dhe vajzave të Shërbimit Social Shtetëror

Më 8 Mars, gratë dhe vajzat e Shërbimit Social në të gjithë Shqipërinë marshuan së bashku për të festuar forcën, përkushtimin dhe dashurinë me të cilat u shërbejnë çdo ditë njerëzve në nevojë. Ato janë frymëzimi i përditshëm i një gruaje që balancon me dinjitet familjen, punën dhe shërbimin ndaj komunitetit. Ky marshim ishte një dëshmi e fuqisë së tyre të jashtëzakonshme dhe e kontributit të pazëvendësueshëm në shoqëri.

Në Ditën Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit për Autizmin, SHSSH u kthye në një ekspozitë të vërtetë kreativiteti dhe përfshirjeje.

Fëmijët e qendrave të zhvillimit u mblodhën në ambientet e institucionit, duke sjellë me vete punimet e tyre artistike, ngjyrat dhe emocionet, të cilat i shprehën me gjurmë duarsh, vizatime dhe buzëqeshje.

Zyrat e SHSSH reflektuan fuqinë e diversitetit dhe mesazhin e qartë se përfshirja është themel i një shoqërie të drejtë dhe të dashur për të gjithë.



Konferenca Rajonale "Avancimi i Reformave të Kujdesit për Fëmijët drejt Anëtarësimit në BE" u zhvillua me fokus të veçantë të Garancia Evropiane e Fëmijëve.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga vendet e BE-së dhe partnerë rajonalë, të cilët ndanë përvoja dhe angazhime për forcimin e politikave sociale. Shërbimi Social Shtetëror riafirmoi rolin e tij si aktor kyç në zbatimin e reformave të mbrojtjes për grupet në nevojë.

Kjo konferencë solli ide dhe zgjidhje konkrete për përmirësimin e jetës së fëmijëve me aftësi të veçanta.



Fëmijët e shtëpisë sonë të "Zyber Hallullit" morën pjesë në aktivitetin më interesant të muajit Maj, në panairin MUSE-X.

Kaluam një pasdite fantastike me fëmijët, ku eksploruam me vëmendje stendat, sipërmarrjet handcraft të të rinjve dhe përjetuam emocionet e Storm Ring dhe Rap Battles.



Këtë Qershor, Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH organizoi një aktivitet festiv në natyrë me fëmijët e institucioneve të përkujdesit shoqëror.

Të pranishme në këtë aktivitet ishin Ministria Koçiu dhe Drejtoresha e SHSSH, znj. Reme Xholi, të cilat ndanë emocionet dhe gëzimin me fëmijët në këtë ditë të veçantë.

Aktiviteti u zhvillua në një fermë, ku fëmijët patën mundësinë të angazhohen në një sërë aktiviteteve argëtuese dhe edukative: përgatitën biskota, vizatuan, morën pjesë në mbledhjen e perimeve dhe patën mundësi të njihen nga afër me kafshët e fermës.

Në Vlorë, gjatë një retreat-i me drejtuesit rajonalë dhe stafet e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror nga mbarë vendi, patëm mundësinë të zhvillonim diskutime të thelluara mbi sfidat e punës së përditshme.

Nëpërmjet një shkëmbimi të frytshëm mendimesh, u sollën në vëmendje çështjet më urgjente dhe u propozuan zgjidhje praktike për të rritur efektivitetin dhe cilësinë e sistemit të mbrojtjes sociale në nivel kombëtar.

Ky retreat shërbeu jo vetëm si një moment reflektimi dhe vlerësimi të punës sonë, por edhe si një hap domethënës drejt rritjes së kohezionit mes nesh, si një ekip i përkushtuar ndaj misionit për të ndërtuar një sistem mbrojtjeje sociale të ndjeshëm ndaj nevojave të qytetarëve.





Më datë 17.06.2025 në Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror znj. Reme Xholi zhvilloi një takim frymëzues me Deboren, presidente e fondacionit amerikan "One Heart Children", themeluesen e fondacionit në Shqipëri dhe sponsoren e programit znj. Erjola Xheko, si dhe znj. Valbona Tula, drejtore e Shtëpisë-Familje për të Rinj 16-18 vjeç.

Ky takim shënoi finalizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe "One Heart Children", për zbatimin në Shqipëri të programit "Gjyshet për Fëmijët", i cili vjen pas një përvoje të suksesshme në Bullgari.

Programi ka për qëllim të sjellë në jetën e fëmijëve që rriten në institucionet e përkujdesit social, figurën e ngrohtë, të përkushtuar dhe mbështetëse të gjyshes. Gjatë fazës së zbatimit, gjyshet do të punësohen në institucionet tona, ku do të bashkëpunojnë me ekipet profesionale për të ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së përkujdesit dhe zhvillimin emocional dhe social të fëmijëve.

Ky program jo vetëm që kontribuon në mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve, por krijon gjithashtu mundësi të vlefshme për angazhimin aktiv të gjysheve në jetën shoqërore, duke nxitur përbushjen personale dhe përmirësimin e shëndetit mendor të tyre.



Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al



SHËRBIMI SOCIAL

BULETINI MUJOR

Korrik
2025

Shërbimi Social Shtetëror, me mbështetjen e Programit Italo-Shqiptar të Konvertimit të Borxhit (IADSA) po zbaton në partneritet me Qendrën ASET, Regione Marche dhe Liguria projektin “EldEarly – Përmirësimi i Sistemit të Kujdesit ndaj të Moshuarve në Shqipëri”, që synon forcimin e mbështetjes për të moshuarit në vendin tonë.

Në kuadër të këtij projekti është ngritur një Linjë Këshillimi falas që ofron:

- Këshillim psikologjik për të moshuarit
- Referim për kujdes të shtuar shëndetësor e social

Telefononi falas në numrin 0800 4042. Linja është e hapur për të gjithë të moshuarit që kanë nevojë për mbështetje sepse çdo i moshuar ka të drejtë të ndihet i sigurt, i dëgjuar dhe i përfshirë.



An advertisement for the EldEarly project. The top half features an elderly woman with glasses smiling while talking on a mobile phone. Text in Albanian reads: "LINJA E GJELBËR PËR TË MOSHUARIT ËSHTË KËTU PËR TY!" (The Green Line for the Elderly is here for you!) and "ÇDO TELEFONATË, NJË PËRQAFIM!" (Every call, a response!). The bottom half shows a woman with curly hair wearing a headset, smiling. Text reads: "TI NUK JE VETËM! TELEFONO FALAS NE NUMRIN 0800 40 42 LINJA E GJELBËRT PËR TË MOSHUARIT!" (You are not alone! Call free on number 0800 40 42, the Green Line for the Elderly!). Logos for IADSA, ASET, Regione Marche, and Regione Liguria are visible at the bottom.

Gjatë muajit korrik 2025, Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli”, nën kujdesin e Shërbimit Social Shtetëror dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, organizoi një kamp veror për fëmijët që ndodhen në institucion.

Kampi u zhvillua në ambientet e pishinave, ku fëmijët patën mundësi të kalojnë ditë të këndshme mes lojërave, aktiviteteve në ujë dhe pushimit aktiv. Këto ditë verore jo vetëm që i kanë ofruar fëmijëve çaste gëzimi dhe argëtimi, por gjithashtu kanë ndihmuar në forcimin e bashkëpunimit dhe ndjenjës së komunitetit mes tyre.

Në këto ditë të nxehta vere, të rinjtë e Shtëpisë Familje 16-18 vjeç morën pjesë në një kamp veror të organizuar në bashkëpunim me *Malteser Albania*, në bregdetin e Velipojës.

Ky kamp u ofroi atyre mundësinë të pushonin, të shijonin detin dhe natyrën, por edhe të forconin shoqërinë dhe ndërveprimin mes tyre.



Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit kundër Trafikimit të Personave u zhvillua një takim me disa nga të mbijetuarat e trafikimit, të cilat ndanë rrëfime të forcës, guximit dhe shpresës.

Përmes historive të tyre u sollën në vëmendje jo vetëm sfidat e kaluara, por edhe mundësitë e reja që hapen kur viktimat marrin mbështetje dhe shansin për një jetë të sigurt.

Ky takim ishte një thirrje për më shumë solidaritet, angazhim institucional dhe shoqëror, në mënyrë që çdo viktimë e trafikimit të gjejë drejtësi, siguri dhe dinjitet.

Pas tre vitesh në shtëpinë tonë A u birësua nga Ana dhe Filipi, dy prindër që kaluan Adriatikon për t'i dhuruar asaj një familje të vërtetë dhe dashuri të pakushtëzuar. Sot A nis një kapitull të ri, duke u rritur mes kujdesit dhe përkujdesjes prindërore që çdo fëmijë meriton.

Çdo fëmijë ka të drejtë për një familje dhe për një të ardhme të sigurt e të mbushur me dashuri.



Në kuadër të projektit “*Gjithëpërfshirje në vendin e punës*” u nënshkrua një marrëveshje mes IPSED dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë.

Ky projekt synon të fuqizojë personat me aftësi të kufizuara për një karrierë të qëndrueshme, të rrisë angazhimin e punëdhënësve si dhe të përmirësojë kapacitetet e aktorëve lokalë për një përfshirje më të gjerë në tregun e punës.



Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al



SHËRBIMI SOCIAL

BULETINI MUJOR

Gusht
2025

Arianna 29-vjeçare, sapo është rikthyer nga SHBA dhe vendosi të bëhet nënë kujdestare për dy fëmijë nga Shtëpia e Fëmijës Korçë. Së bashku me bashkëshortin, Tomas, ata hapën shtëpinë dhe zemrën e tyre, duke ofruar dashuri dhe mbrojtje për dy të vegjlit.

Kjo është një histori frymëzuese e kujdesit alternativ me bazë familjare. MSHMS dhe institucionet e varësisë po punojnë për një kuadër të ri ligjor, të harmonizuar me standardet e BE-së dhe Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, me synimin që çdo fëmijë të rritet në një familje, me dashuri, mbrojtje dhe shpresë për një të ardhme më të mire.



Në kuadër të zbatimit të programit “Gjyshet Për Fëmijët” nënat tona kujdestare janë bërë pjesë e pandashme e jetës së fëmijëve.

Fëmijët i presin me padurim për të nisur bashkë aktivitete të shumta që zhvillojnë vetëbesimin, personalitetin dhe empatinë.

Së bashku, argëtohen por edhe mësojnë punë të vogla si gatimi i biskotave me recetat e gjysheve, qëndisja e kështu me radhë.

Fëmijët e familjes sonë të “Zyber Hallullit” kaluan 2 javë të paharrueshme në shtëpinë e pushimit Velipojë.

Ata shijuan detin, lojërat në ujë, aktivitetet argëtuese dhe shëtitjet e mbrëmjes, duke krijuar kujtime të bukura.

Pranë tyre ishte stafi i dedikuar i institucionit, të cilët u kujdesën për sigurinë dhe argëtimin e fëmijëve, duke i bërë pushimet edhe më të ngrohta e familjare.



Ditët e nxehta të verës, fëmijët e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës i kaluan duke u freskuar në plazhin e qytetit, të shoqëruar nga vullnetarët e Kishës Katolike.

Me përkushtim dhe dashuri, vullnetarët janë gjithmonë pranë fëmijëve me AK, duke i mbështetur me aktivitete të gëzueshme dhe treguar përkujdes përgjatë gjithë kampit.



Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al



SHËRBIMI SOCIAL

BULETINI MUJOR

Shtator
2025

Takimi me 12 Drejtorët Rajonalë të SHSSH ishte më shumë sesa një mbledhje pune; ishte moment reflektimi, bashkëbisedimi dhe ndarje të vizionit të përbashkët për rrugën që kemi përpara deri në fund të vitit.

Në këtë takim u ndalëm për të analizuar sfidat aktuale, për të ndarë përvojat nga terreni, si dhe për të identifikuar zgjidhje konkrete që mund të përmirësojnë punën tonë të përditshme.

Ky takim shënon vijimësinë e një vizioni të qartë për të ngritur një standard të ri të shërbimit social, duke vendosur në qendër qytetarin.



Në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijë, kujdestarët u kujdesën që çdo fëmijë të ndjejë gëzimin dhe emocionin e këtij fillimi të ri, me veshje, mjete shkollore dhe shumë dashuri.

Ky moment simbolik, por domethënës, tregon përkushtimin e SHSSH-së për të qenë pranë çdo fëmije, duke siguruar jo vetëm mbrojtje, por dhe mbështetje të vazhdueshme për arsimimin dhe zhvillimin e tyre personal.



Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al



SHËRBIMI SOCIAL

BULETINI MUJOR

Tetor
2025

Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, po zbaton një nismë që synon kthimin e pasurive të sekuestruara në mbështetje konkrete për qytetarët në nevojë.

Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër trafikimit të personave, Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH, znj. Reme Xholi, dhe Kryeadministratorja e AAPSK, znj. Risena Xhaja, zhvilluan vizita në disa institucione të përkujdesit shoqëror që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit, por jo vetëm, dhe një sërë pasurish të sekuestruara iu shpërndanë përfituesve të këtyre qendrave, duke u vënë në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës.



U zhvillua një tryezë pune që bashkoi 29 drejtues të institucioneve të përkujdesit shoqëror në varësi të pushtetit vendor dhe Shërbimit Social Shtetëror, me një qëllim të përbashkët: ofrimin e kujdesit cilësor, gjithëpërfshirës dhe dinjitoz për personat që kanë më shumë nevojë për mbështetje.

Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Reme Xholi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm midis institucioneve të përkujdesit shoqëror dhe strukturave vendore për të siguruar shërbime sa më efektive dhe të unifikuara për përfituesit. Ajo vuri në dukje se përmirësimi i standardeve të përkujdesit kërkon komunikim të hapur, koordinim të ngushtë dhe përfshirje aktive të të gjithë aktorëve të sistemit të mbrojtjes sociale.



Në një atmosferë bashkëpunimi dhe reflektimi u zhvillua workshopi për prezantimin e Hartës së Shërbimeve Sociale 2025 – një instrument i fuqishëm në duart e qytetarëve, profesionistëve dhe politikëbërësve.

Për qytetarët: më shumë informacion dhe akses në shërbimet pranë vendbanimit.

Për politikëbërësit: vendimmarrje më të zgjuar dhe të bazuar në evidenca.

Për profesionistët: bashkëpunim dhe koordinim më i fortë në terren.

Zhvillimi i hartës së shërbimeve sociale dëshmon angazhimin e MSHMS dhe SHSSH për ndërtimin e një rrjeti kujdesi gjithëpërfshirës dhe dinjitoz për grupet në nevojë.



Në kuadër të 1 Tetorit, Ditës Ndërkombëtare të Moshës së Tretë, u realizua një tur ndërgjegjësues nga veriu në jug, ku mjeti ynë u përçoi qytetarëve të mbarë vendit mesazhin për vëmendje, përkujdes dhe dashuri për gjyshërit, sot e gjithmonë.

Në këtë rrugëtim na u bashkuan profesionistë të kujdesit social e shëndetësor, përfaqësues institucionesh, nxënës shkollash dhe vetë gjyshërit tanë, të cilët ndanë mesazhe të fuqishme për rëndësinë e respektit, përkujdesit dhe lidhjes së fortë ndërmjet brezave.



SHSSH me mbështetjen e Programit IADSA II, po zbaton në bashkëpunim me Qendrën ASET, Regione Marche dhe Regione Liguria projektin “eldEARLY – Përmirësimi i sistemit të përkujdesjes ndaj të moshuarve në Shqipëri”.

Në kuadër të këtij projekti kanë nisur zyrtarisht trajnimet e akredituara falas për dy profile të reja profesionale që po prezantohen për herë të parë në Shqipëri:

- Operatori i Asistencës Shtëpiake
- Operatori i Linjës së Këshillimit



Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al



BULETINI MUJOR

Nëntor
2025

Shërbimi Social Shtetëror nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, me synim forcimin e mbështetjes sociale për familjet në nevojë. Marrëveshja vendos një mekanizëm të përbashkët, të strukturuar dhe funksional për identifikimin në kohë të familjeve vulnerabël, kryefamiljari i të cilave ndodhet në institucionet e vuajtjes së dënimit, duke garantuar një qasje të koordinuar dhe efektive ndërinstitutionale.

Qëllimi ynë është i thjeshtë dhe njëkohësisht thelbësor: të jemi pranë çdo familjeje, t'i dëgjojmë, t'i vlerësojmë dhe t'i orientojmë drejt shërbimeve dhe përfitimeve që garanton legjislacioni i mbrojtjes sociale.



Në kuadër të fushatës “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës”, Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH znj. Reme Xholi zhvilloi një orë të hapur me studentët e Departamentit të Punës Sociale dhe Politikave Sociale.

Gjatë këtij bashkëbisedimi u ndanë reflektime dhe mesazhe mbi angazhimin e vazhdueshëm të Shërbimit Social Shtetëror në parandalimin e dhunës dhe forcimin e përgjigjes institutionale ndaj saj, në të gjitha format që ajo shfaqet, duke theksuar rolin e shërbimeve sociale në mbrojtjen e individëve dhe familjeve më vulnerabël.

Me z. Rada, drejtues i Departamentit të Punës dhe Politikave Sociale, u diskutua mbi rolin kyç të studentëve si profesionistë të ardhshëm dhe agjentë të ndryshimit social.



Në prag të festave të Nëntorit, në shtëpinë e Hannës dhe Rozafës, të ndërtuar me dashuri dhe përkushtim, Shërbimi Social Shtetëror ndau momente të veçanta me prindër birësues.

Gjatë këtij takimi, prindër birësues, shqiptarë dhe të huaj, ndanë përvojat e tyre të birësimit, rrugëtimin e ndjekur dhe ëndrrat për të ardhmen. Shërbimi Social Shtetëror shpreh mirënjohje për këtë akt të madh human, që u ofron fëmijëve dashuri, siguri dhe një perspektivë të qëndrueshme për të ardhmen.

Këtë Nëntor, festat priten me urimin dhe dëshirën që Nëntori i ardhshëm të gjejë sa më shumë fëmijë pranë familjeve që i duan, i mbështesin dhe u japin një shtëpi të mbushur me dashuri.



Fëmijët e familjes sonë të madhe Zyber Hallulli festuan me gëzim dhe emocion festat e Nëntorit, në një atmosferë të mbushur me ngjyra, buzëqeshje dhe energji pozitive.

Kjo ditë festive u bë edhe më e veçantë nga prania e aktorëve të "Portokallisë", të cilët sollën humor, gëzim dhe shumë të qeshura për fëmijët. Programi artistik u pasurua nga një koncert i bukur i dhuruar nga vetë fëmijët, të cilët, të shoqëruar në piano nga profesori i tyre, interpretuan këngë, valle dhe recitime, duke treguar talentin, përkushtimin dhe dashurinë për artin dhe kulturën. Në përmbyllje të aktivitetit, fëmijët u argëtuan me animatorin, duke vijuar festën me lojëra, kërcime dhe aktivitete zbavitëse.





Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al



SHËRBIMI SOCIAL



BULETINI MUJOR

Dhjetor
2025

Në prag të Vitit të Ri, Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH, znj. Reme Xholi, zhvilloi një sërë vizitash pranë gjyshërve, fëmijëve dhe familjeve në nevojë në mbarë vendin, duke ndarë me ta urimet më të mira për një vit të ri sa më të mbarë, me shëndet, shpresë dhe mirëqenie.

Këto vizita përfaqësojnë një shenjë konkrete të kujdesit dhe vëmendjes ndaj shtresave më vulnerabël të shoqërisë, veçanërisht në një periudhë festash që simbolizon solidaritetin dhe humanizmin.



Në kuadër të nismës “Një kuti, një arsye për të buzëqeshur”, të ndërmarrë nga SHSSH dhe MSHMS u mbledhën dëshirat e 138 fëmijëve pa kujdes prindëror, të sistemuar në 6 institucione të përkujdesit shoqëror në mbarë vendin.

Kjo nismë synoi t’u sillte gëzim dhe emocion fëmijëve në prag të festave, duke u dhënë mundësinë që dëshirat e tyre të bëheshin realitet. Nismës iu bashkuan deputetët e Partisë Socialiste, të cilët, me përkushtim dhe solidaritet, plotësuan dëshirat e shprehura nga fëmijët. Si pjesë e kësaj nisme, u organizuan gjithashtu aktivitete festive dhe argëtuese me fëmijët, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë, plot buzëqeshje dhe momente të paharrueshme, që forcojnë ndjenjën e përkujdesjes dhe përfshirjes sociale.

Më 31 dhjetor, në prag të ndërrimit të viteve, Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Reme Xholi, së bashku me Drejtoreshën e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, znj. Adelaida Roka, vizituan Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli”, duke sjellë dhurata, përqafile dhe gëzim, e duke e bërë këtë fundvit më të veçantë për ta.



Akademia e Futbollit ‘Partizani’ hapën sot dyert e saj për dy djemtë Shtëpisë së Fëmijës ‘Zyber Hallulli’, të cilët ndajnë një ëndërr të përbashkët: futbollin.

Së shpejti, dy vëllezërit do të fillojnë stërvitjet në Akademinë e Futbollit ‘Partizani’ dhe do të kemi mundësinë t’i shohim të luajnë në ndeshje të rëndësishme, ndërsa do të gëzohemi dhe do të mbështesim çdo arritje të tyre.



Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al